

Paradhënie Bankare për Individë (OD Retail)

Informacion rreth Bankës

Intesa Sanpaolo Bank Albania

Drejtoria Qendrore: Rr "Ismail Qemali", Nr. 27,
Kutia postare 8319
1001 Tirane, Shqipëri
Tel: +355 4 22 76 000; Fax +355 4 22 48 762
Website: www.intesasanpaolobank.al

Karakteristikat dhe rreziqet e Paradhënie Bankare për individë (OD Retail)

Karakteristikat e "OD Retail"

Paradhënia Bankare për Individë është një kredi konsumatore që u ofrohet individëve, rezidentë ne Republikën e Shqipërisë, me të ardhura të mira financiare dhe historik të mirë kredimarrje, të cilët janë Klientë të Bankës të paktën prej 1 viti. Kredia ofrohet për një periudhë afat-shkurtër dhe synon të përmbushë nevojat e klientëve për likuiditet. Shuma e paradhënies bankare mund të përdoret dhe të ripërdoret disa herë brenda limitit dhe afatit të aprovuar nga Banka. Kredia do të disbursohet ne llogarine rrjedhese te Klientit, dhe nese llogaria bankare ka titullar te tjere Kontrata e Kredise me Kufi do te firmoset nga te gjithë titullaret e llogarise.

Tregu i synuar

Paradhënia Bankare për Individ është një kredi konsumatore që u ofrohet individëve, rezidentë ne Republikën e Shqipërisë, me të ardhura të mira financiare dhe historik të mirë kredimarrje, të cilët janë Klientë të Bankës të paktën prej 1 viti.

Opsione të tjera shtesë

Klienti mund të përdore paradhënien sipas diskrecionit të tij për çdo qëllim. Edhe nëse klienti nuk e përdor menjëherë atë, ai e ka paradhënien të vlefshme në llogarinë e tij dhe mund ta përdorë atë në çdo kohë, për çdo situatë dhe ngjarje të paparashikuar (24 orë në ditë/ 365 ditë në vit nëpërmjet Kartës së Debitit). Afati i paradhënies per individe eshte 1 vit, i rinovueshem ne rastin kur klienti ka aftesi paguese dhe histori te mire kredie.

Dokumentet e nevojshme

1. Konfirmimi i pagës lëshuar nga punëdhënësi i cili vërteton shumën e pagës dhe datën e punësimit (data e fillimit të kontratës së punës) ose kontratën e qirasë në rastin kur klienti përfiton të ardhura nga qiraja.
2. Historiku i llogarisë së klientit për 12 muajt e fundit
3. Kopje e dokumentit të vlefshëm të identifikimit;
4. Të dhëna nga Regjistri Kombëtar i Kredisë.

Shërbime suplementare

Shërbimi suplementar që ofrohet së bashku me Paradhënien për Individë është llogaria rrjedhëse e cila mund të përdoret për të gjitha transaksionet e tjera operationale, si edhe një kartë debiti për të garantuar që klienti ka akses të shumës së dhënë çdo 24 orë.

Rreziqet e "OD Retail"

Në rastin kur Paradhënia Bankare është dhënë ne Eur/USD dhe të ardhurat janë ne Leke, ekziston rreziku që lidhet me luhatjen e kursit të këmbimit.

Struktura e çmimit:

Interesi vjetor që Kredimarrësi detyrohet t'i paguajë Bankes eshte nje norme fikse dhe e pandryshueshme. Interesi vjetor që Kredimarrësi detyrohet t'i paguajë Bankës aplikohet me baza vjetore dhe metoda e llogaritjes është numri i ditëve/360.

Kushtet kryesore ekonomike

Norma Vjetore e Interesit

Interesi vjetor që Kredimarrësi detyrohet t'i paguajë Bankës aplikohet me baza vjetore dhe metoda e llogaritjes është numri i ditëve/360 (numri i ditëve/treqind e gjashtëdhjetë). Interesi për llogaritjet cdo ditë mbi shumën e përdorur të

'Principalit' të rezultuar në fund të cdo dite dhe paguhet cdo muaj në datën e pare të punës së muajit pasardhës.

OD Retail

Norma vjetore e interesit në LEK 13 %

Norma vjetore e interesit në EUR 13 %

Norma vjetore e interesit në USD 13 %

Shuma që mund të financohet dhe afati

Karakteristikat

Shuma minimale USD 500 / LEK 50,000 / EUR 400

Shuma maksimale USD 10,000 / LEK 1,000,000 / EUR 10,000

Afati 1 Vit

*Shembull ilustrativ për llogaritjen e interesit të paradhënies bankare

*Nëse klienti do të aplikojë për shumën e paradhënies bankare prej LEK 1,000,000.00, për një afat prej 1 vit dhe normë interesi 13%, interesi total që i paguan bankës per 1 vit është 130,000 Leke.

Shuma e paradhënies bankare	1,000,000 LEK
Afati	1 vit
Norma vjetore e interesit	13%
Totali i interesave te paguara	130,000 LEK
Totali i kredisë/kësteve	1,130,000 LEK
Komisioni administrimit	7,800 LEK

*Shembulli i Personalizuar dhe vlerat e sipërpërmendura kane karakter ilustrativ dhe prezumojne perdorimin e të gjithë shumës përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kredisë dhe do të ndryshojnë në varesi te shumës së kredise së përdorur nga Kredimarrësi dhe kohezgjatjes së përdorimit.

Kostot dhe shpenzimet për lidhjen e kontratës dhe menaxhimin e marrëdhënies kontraktore

Kostot dhe shpenzimet për lidhjen e kontratës

Pagesa të tjera:	N/A
Komisioni i parapagimit	Falas

Kostot dhe shpenzimet për menaxhimin e marrëdhënies kontraktore

Komisioni i mirëmbajtjes së llogarisë së OD Retail	Sipas kushteve të punës për Individë
Komisioni i administrimit	2% e shumes (min. 1,500 LEK; 10 EUR; 15 USD dhe max. 7,800 LEK; 70 EUR;75 USD) per shuma <= 200,000 LEK/ 1,650 EUR/ 1,900 USD.
	2% e shumes (min. 3,000 LEK; 20 EUR; 30 USD dhe max. 7,800 LEK; 70 EUR; 75 USD) per shuma > 200,000 LEK/ 1,650 EUR/ 1,900 USD

Kamatevonesa	ALL: 27%; EUR: 21%; USD: 21 %
Kostot e komunikimit:	
Kosto e komunikimeve ligjore shkresore	Falas
Kosto e komunikimeve ligjore online	Falas
Njoftim me shkrim për përfundimin e afatit dhe/ose marrjen e pagesës	Nuk aplikohet
Njoftim elektronik (SMS) për përfundimin e afatit dhe/ose marrjen e pagesës	50 Lek (Opsionale, sipas kërkeses se klientit)
Amendimi i kontratës së OD Retail	Pa pagesë
Lëshimi i konfirmimit bankar	1,000 Lek (Opsionale, sipas kërkeses se klientit)

Plani i amortizimit

Periodiciteti i pagesës së interesit	Çdo muaj
--------------------------------------	----------

Ripagimi para afatit, ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore dhe ankesat

Ripagimi para afatit

Klienti mund të ripagujë kredinë në çdo kohë duke njoftuar Bankën të paktën 15 ditë përpara datës së likuidimit.

Ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore

Çdo ndryshim i kushteve të përcaktuara shprehimisht në Kontratën e OD Retail do të jetë efektiv pas miratimit me shkrim të palëve. Asnjë ndryshim i kushteve të përcaktuara shprehimisht në kontratën e OD Retail nuk do të jetë efektiv nëse palët nuk bien dakord me shkrim.

Ankesat

Ankesat mund të paraqiten në bankë duke përdorur një nga format e mëposhtme:

- Me shkresë dërguar në Bankë me postë;
- Në degë tek "Kutia e ankesave & sugjerimeve" (Ju dëgjojmë 100%);
- Ankesat me shkrim nëpërmjet llogarisë së email-it në adresën zyrtare të website-it të Bankës si më poshtë: complain@intesasanpaolobank.al
- Nëpërmjet qendrës së thirrjeve telefonie Call Center në numrin: 08006000

Afati kohor për përgjigjen nga ana e Bankës është maksimalisht 30 ditë nga data e marrjes së ankesës.

Fjalorthi i Termave Kryesore

EURIBOR- (Euro Interbank Offered Rate, norma e publikuar në sistemin Thomson Reuters në faqen EURIBOR në orën 13:00 CET. Informacioni për llogaritjen e këtij indeksi ndodhen në website: <http://euribor-ebf.eu>).

Bono Thesari (T-BILL) - do të thotë Interesi i Rezultuar nga Ankandi i Fundit i Bonove të Thesarit, të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Informacionet në lidhje me përlllogaritjen mund të gjenden në faqen: www.bankofalbania.org.